



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e X) me dt.02.12.2024

DEÇAN

e Hënë, 02 Dhjetor 2024

Faqe 1 nga 24

Hajdar Sutaj

Të nderuar kolegë, të nderuar drejtor, të nderuar anëtarë e anëtare të kuvendit të komunës, mirë se keni ardhur në mbledhjen e 10-të të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2024, për mbledhje propozoj këtë

Rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar,
2. Caktimi i normave tatimore për tatimin në pronë për vitin 2025,
3. Të ndryshme.

Nëse dikush prej jush ka diçka me shtu sa i përket rendit të ditës, e hapi diskutimin, Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Përshëndetje edhe një herë për të gjithë, atëher i nderuar kryesues, qështja që kisha dashtë të inkuadrohet tek të ndryshmet ka të bëjë me propozimin që unë kam bërë në komisionin për ndarjen e bursave, i cili propozim ka gjetur përkrahjen edhe nga anëtarët e tjerë të komisionit që sot të vijmë në asamble, propozimi për shfuqizimin e vendimit që e kemi marrë në asamble muajin kaluar për formimin e komisionit, i cili është në kundërshtim me rregulloren për ndarjen e bursave, kështu që kur vij rendi të diskutohet, i potencoj argument pse kam kërku që ky propozim në komision të vijë në asamble dhe pse duhet të ndryshohet dhe të themelohet (një)1 komision në bazë të rregullores për ndarjen e bursave, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë e nderuar kolege, nuk jam njoftu, nuk ka një shkresë, nuk ka një argument që e keni afuar, domethënë personalisht unë si kryesues kuvendi nuk jam i njoftum dhe ne radhë të parë unë duhet mu njoftu dhe pastaj kolegët duhet mi njoftu me shkrim si e tillë, unë nuk e hedh në votim, mund të diskutohet te të ndryshmet, por si pikë të rendit të ditës, nuk e vendos në diskutim, jo e përfundove, Vatani.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, përshëndetje për të gjithë, po ashtu kryesues e njëjta situatë është edhe tek komisioni i ankesave për ndarjen e bursave, ku sipas rregullores thotë se duhet të jetë 1 zyrtar nga Dka-ja dhe 2 anëtarë nga kuvendi komunal, por ne aty kemi 5 anëtarë tanimë, pra numri është shtuar dhe kemi të bëjmë me thyerje të rregullores, kështu që do të ishte mirë që këtë ta diskutonim tek pika e të ndryshmeve, jo ta futim si pikë të re të rendit të ditës, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë dikush tjetër diçka sa i përket rendit të ditës? Atëherë i qes kështu në këtë përbërje në këto 3 pika që i propozova kush për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet që kuvendi i komunës i ka miratuar rendin e punës po ashtu më lejoni që të ritheksoj që nga 27 anëtarë të kuvendit, 22 janë present, që ka kurum të mjaftueshëm me vazhdu me punimet e Kuvendit të Komunës, që kemi te pika e parë shqyrtimi dhe miratimi i transkriptës nga mbledhja e kaluar a ka dikush diçka në lidhje me transkripten me thanë? Nuk ka, e qesë në votim kush është për?

A ka kundër?

Abstenim nuk ka?

Konstatohet që kuvendi mënyrë unanime e ka votuar transkriptin nga mbledhja e kaluar, kemi te pika e 2-të është caktimi i normave tatimore për tatimin në pronë për vitin 2025 shkresën të cilën e kemi për punën, të cilën e ka dërguar drejtorja për buxhet dhe financa veç e kemi marrë me material paraprakisht ja kaloi fjalën drejtoreshës për buxhet dhe financa Dafina Cacaj dhe pastaj e hapim diskutimin te përfaqësuesit e subjekteve, pastaj te anëtarë të kuvendit, Drejtoresh është fjala për ju, mundësisht e lëshoni fjalën në foltore.

Dafina Cacaj

Mirmëngjes, përshëndetje për të gjithë, propozim vendimin të cilin e kemi bashkangjitur me materialin e asambles të cilin e kemi sjell, është vendimi, është propozimi sikur vitin e kaluar normat tatimore nuk kanë ndryshu, për shkak se ligji për tatimin në pronë në vitin 2023 ka pasur ndryshim në nenin 9 dhe ka pas rritje të normave të tatimit në pronë, duke u bazuar në plotësim ndryshimet edhe këtë vit ka pas me u vlerësu sipas ndryshimeve të vitit 2023, jo me normat tatimore që kanë qenë këtë vit po me vlerën e vlerësuar të objektit ose pronave dhe kish me qenë një dëmtim shumë i madh sidomos për komercialet, sepse do të kishte rritje të

tatimit në pronë dyfish edhe trefish duke u bazuar në këtë ligj për këtë arsye, ministria e financave dhe qeveria kanë marrë 1 vendim, e kanë pezulluar nuk e di a ka kalu ende në parlament. E kanë mendu që ma mir edhe vitin 2025 me shku me normat tatimore, të cilat kanë qenë këtë vit edhe me ligjin bazik pa ndryshime, për shkak se tash janë edhe zgjedhjet dhe fushata na konvenon më shumë mos me u prish me qytetarin, po me vazhdu si kemi qenë edhe për këtë arsye i kam sjell normat tatimore më të ulëta qysh i kemi pasë dhe vitin e kalum që mos me pasë ndonjë ndryshim tjetër, në rast që nuk votohet atëherë ministria financave shkonë me norma më të ulëta sipas ligjit që janë përcaktu me u inkorporu në rregulloren e përgjithshme që është faleminderit, unë nuk kam diçka tjetër nëse keni ju pyetje.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtoreshë për prezantimin, në emer të grupit të AAK-së, Arian Dobraj.

Arian Dobraj

Faleminderit kryesues Sutaj, faleminderit edhe drejtoreshes Dafina Cacaj për sqarimet. Të nderuar koleg, të nderuar drejtor të drejtorive, në fakt me qenë se është edhe miratim ose dokument i miratuar nga ministria përkatëse qeveria e Republikës së Kosovës, nuk kemi diçka për me shut, domethënë ne tregohemi pak realist meqenëse edhe jemi para mediave, që të mos mbetet si përgjegjësi vetëm e kuvendit komunal. Ne, asnjëherë nuk jemi që qytetarëve të komunës sonë, veçanërisht të ju rëndohet jeta financiarisht, por meqenëse ka ardhur (një)1 vendim nga ministria, atëhere jemi të pajtimit me të tillë, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Arian, nga Ldk-ja Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues faleminderit edhe nga drejtoresha për shpjegimet, edhe pse unë mendoj pakë më ndryshe, meqenëse ju keni referuar ligjit bazik që është ligji për tatimin ne prone, ky e ka një afat ligjor, i cili komunat ose kuvendet komunale kanë të drejtë deri më 30 nëntor për ti bërë propozimet, une shtroj 1 pyetje, çka nëse ministria e financave i aplikon tatimet ose ose normat tatimore të vitit kaluar, meqenëse ju veç e keni tejkaluar afatin prej 3 ose 4 ditë sa është, për shkak se ju keni pasur mundësi ligjore deri me 30, kjo ka mujt mu majt edhe në seancat e parafundit dhe e 2-ta, te normat, i vetëdijshëm se ligji bazik është 06 për 2005, ky është ligji bazik dhe këto norma te neni 9 pika prej 1.1 deri 1.9 i lejon disa lëvizje të lehta, a ka mundësi te kategoria e parë dhe e dytë me pas një lëvizje të lehtë, meqenëse e parasheh deri ne 0.5 deri 15, ju keni paraparë 0.10 që ky 0.10 te 2 kategoritë e 1-ra, a ka mundësi për të ja mundësuar qytetarëve, meqenëse unë e vlerësoj se te pjesa bujqësore më shumë është kategori për mbijetesë pjesa komerciale është më shumë për standard, faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Myftar, nga Vetëvendosja Faton Selmanaj e ka fjalën.

Faton Selmanaj

Përshëndetje për të gjithë, ne nuk kemi me shtu diçka, veç pajtohem me këtë vendim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë zotri Selmanaj, zotri Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesus, përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm, kur jemi te neni per prona tatimore, ndoshta është ndonjë gabim teknik ku thuhet se kuvendi komunal i komunës së Deçanit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, prandaj po duket se ky tekst është bërë copy paste dhe është ardhë këtu, në qoftë se une nuk jam gabim. Ndërsa, sa i përket këtyre normave, unë plotësisht pajtohem që sipas vendimeve që janë ardhur nga ministria e financave faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Mon, drejtoresh fjala për juve.

Dafina Cacaj

Pasi që qenka deri me 30 nëntor, është shumë reale që ne e kemi marr të vitit të kalum për shkak se unë i kam

pritur ndryshimet në shumë komuna kanë votu me ligjin e ri me i plotsu ndryshimet e ligjit të ri edhe tash duhet me e fut përsëri në asamble për me bo ndryshime, ne e kemi pritur datën 30 nëntori, unë e kam pritur nëntorin se nuk e kom ditë sakt kur caktohet asambleja edhe me i votu sikur të vitit të kalum për arsye se edhe janë më të ulta edhe nuk kemi pasur mundësi me bë ndryshime për shkak se na kemi qen te pregaditur me ligjin e ri norma tatimore qysh janë përcaktu edhe po mundet me tu dok si copypaste se na e kemi marrë thash edhe më heret, jom shku me norma tatimore te vitit të kaluar si janë këtë vit edhe për vitin tjetër, ne mundemi me bo ndonjë ndryshim që ju e vleroni nuk vshtë ndonjë problem mirëpo tash sa na merret parasysh pasi që ka kalu 30 nëntori nuk e di nëse nuk votohet edhe nëse komuna nuk e çon me kohë, atëherë shkojnë me normat tatimore të fundit që janë votu në asamble.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, e hapim diskutimin, a ka dikush tjetër nga kolegët me thanë diçka? Po, Miftar Ahmetxhekaj, tash fol si asambleist.

Miftar Ahmetxhekaj

Drejtoreshë, gjithnjë po i referohem ligjit bazik, ligji bazik neni 9 e saktëson kuvendet komunale kanë të drejtë munden, për ti bërë, për ti përcaktuar normat tatimore deri më 30 nëntor. Shqetsimin e kamë që ne se kemi bërë këtë punë dhe tash kamë drojë, që vetëm votojm kot për shkak se tash futet në kombinim ligji bazik, i cili ministria e financave përcakton normat këtu unë e kamë dilemën, dhe e 2-ta, neni 39A, prap nuk po du me u kthy te Moni, po keni bërë kopje se ky është nen tranzitor, ky nen që i ka përcaktu vetëm për normat ju keni përcaktu 2023 për 2024 dhe edhe fundit te lehtësimet e lehta, prapë jam që nëse prapë nëse ka mundësi ligjore ose ose dhe objektive te kategoria e 1-rë dhe e 2-të, pikërisht te kategorit bujqësore, te ketë (një)1 zbritje të lehtë nëse ka mundësi 0.8 pse jo, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, a ke diçka drejtoreshë në lidhje me propozimin e Miftarit, a lejohet, në rregull faleminderit, dikush tjetër.

Kush është për propozimin e Miftarit kolegut Miftar Ahmetgjekaj, faleminderit.

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj qe me 22 vota për e kemi përkrah propozimin e kolegut Miftar, tash e qes me këtë votim që e bëmë edhe propozimin e drejtoreshes, e qes në votim kush është për këto norma tatimore 2025?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Nuk ka, konstatoi që kuvendi e miratoi në mënyrë unanime normat tatimore për vitin 2025 dhe e kemi mbyllur edhe pikën e 2-të të rendit të ditës, jemi tek të ndryshmet. Dikush tek të ndryshmet, Faton Selmanaj, Mon Selmanaj, pastaj Albesa Cacaj, Faton udhëro, fjala për juve.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues, unë i kam disa pyetje për drejtorat të cilët janë këtu, e para është për drejtorin e shërbimeve publike, lidhur me tarifat e mbeturinave për biznese. Ka biznese, gastronomia që paguajnë tarifa shumë të larta drejtor edhe kërkesa është që të pakten ju si drejtori, përmes ndërmarrjes me kërku që shërbimet me u kry si duhet, sepse ndodh shpesh që as shërbimet nuk jan duke u kryer siq duhet dhe mundësisht me rishiku ose me kategorizu si kategori më të veçantë. Për shembull, shërbimet e gastronomisë veq për kafene me u ul, me pas një tarifë ma të ulët raport me bizneset e mëdha që mbajnë më shumë mbeturina. Çështje tjetër, është pengesat në disa rrugë në fshatin Irzniq, është një qytetar të cilin e kam pa që është ankuar edhe ka marrë shembuj krahasues, shembull në fshatin Llukë ka bo me u vendos ato pengesa, në fshatin Irzniq nuk ka bo, dhe nuk është lejuar as nuk është jep leje me vendos vet as nuk keni shkuar si institucion edhe mundësisht me ndërmarrë ndonjë veprim, me vendos qoft donjë polic të vdekur, qoftë ndonjë pengesë të llojit tjetër, qysh janë vendosur në disa fshatra. Sepse, jeta e banorëve në disa prej lagjeve aty është në rrezik. (Një)1 pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë tjetër, drejtoreshë lidhur me me praktiken në QKMF, pse po bëhen pranime selektive disa studentëve të fushës së infermierisë po ju mundsohet praktika ne QKMF, e disa te tjerëve jo. Po ashtu, për listën e barnave esenciale, është duke u vërejt që ka mungesë, për këtë e di edhe përgjigjen që keni me dhënë, por duhet me pas kujdes të shtuar edhe ju si drejtori edhe pyetja e fundit është për drejtorin e administrates, me gjasë nuk po e di sakt cilës i takon, po pse nuk janë kompenzuar kryetarë të bashkësive lokale të fshatrave? faleminderit.

Hajdar Sutaj

A e përfundove, faleminderit shumë, drejtorat kanë mundësi mu përgjigj tash pasë cdo diskutuesi ose me lënë për fund, qysh e vlersoni, Drejtori Izet Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Kolegë, drejtor, asambleist, kryesues të tarifave për bizneset është rregullorja, e cila përcakton qart dhe i kategorizon dhe mendoj që është çmimi i kësaj real dhe është rregullore që është miratuar nga asambleja do të thotë ju kanë nënshtruar diskutimit publik ka kaluar në asamble 2 herë dhe ka marrë aprovimin nga të gjithë dhe qofse e shihni të arsyeshme për me bo ndryshimin e rregullores mundem bart në asamble tashë me 1 kërkesë që me ju nënshtruar vendimit të rregullores edhe mi dhënë propozimet secila që janë të arsyeshme edhe për biznese, por edhe për qytetarë sidomos të gastronomisë është e përcakton qartë me zbarzje aq sa rigjeneron mbeturina aq edhe paguan të Pengesat në fshatin Irzniq do të thotë pëlqimin e kanë marrë qytetarët nuk është ekzekutuar nga komunës për arsye se.. është momenti që punojnë në Irzniq vendosen ato 3 pengesat të institucioneve, domethënë institucionet, Deçan i ka 400 kilometra asfalt 350 kilometra kalojnë rreth dyerve të njerëzve do të thotë duhet me shtrë Deçanin në një far forme krejt tjetër e besoj në momentin që njerzit hyn me punë kanë me u krye edhe ato pengesat që kanë bo kërkesën kryesia e fshatit pëlqim ju ka dhënë për me i qit vetë ka qenë inspektori transportit publik dhe komunikacioni e ka parë vendin që është e nevojshme, sidomos të shkolla dhe të rruga lagjja Dervishaj kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor, fjalën e ka Mon Selmanaj Pastaj... po edita por sigurisht e ka lënë për fund me u përgjigj ose qysh ta vlersojn Mon Selmanaj është lajmruar për fjalë në rregull Dafina Cacaj Dëshiron fillimisht dëshiron me u përgjigj në pyetjet e kolegut.

Dafina Cacaj

Në lidhje me kompensimin e këshillave të fshatrave e pas përzgjedhjes të tyre që u bo edhe janë emruar ata nuk kanë mbajtur takim ose kanë mbajtur takime pa evidencë dhe pa proces verbal cila që nuk kanë mujt me dëshmu se ata kanë mbajtur takime dhe unë kam mujt me i kompensu momentin që ti e ki do letra që kemi mbajtur takime dhe unë tani e kam një arsye qysh mundem mi kompensu në takimin e fundit që kam qenë unë jam shku në takime dhe jau kom spjegju i kanë përgatitur disa dokumente të cilat i kanë mbajtur 2 takime edhe i kanë sjell lejet dhe konfirmim atë llogari të cilat duhet mi fut në sistem për me mujt me jau qit parat. Në i kemi kryer këto procedura tashti vetëm sa tmundemi me ju bashkangjitur sistemin dhe me jau kompensu përnjëher të gjithëve për një takim ose dy që i kanë mbajtur këta mujt e fundit ma heret nuk e di ku kanë mbajtur por nuk kanë pasë një list të evidentuar me nënshkrime që kanë mbajtur edhe procesverbalet, po të takimeve të fundit veq i kanë kompletuar dhe jemi duke u munduar me i bo të gjithë edhe me jau qit të gjithëve mos me mbet dikush po e dikush jo.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Drejtoresha Agnesa Vokshi e ka fjalën.

Agnesa Vokshi

Përsëritet për gjith faleminderit kolegj për pyetjen e fillimisht po du me tu përgjigjet pyetjen për praktikant që e bëre unë nuk po besoj që ka ndonjë përzgjedhje selektive dhe nuk guxojnë me ndodh kjo të paktën mbas asaj që unë jam e informueme, kështu që çdo praktikant që paraqitet te ne me mbajtur praktike në kujdes parësor shëndetësor, në bazë të legjisllacionit që e kemi në fuqi dhe asaj që neve na takon si kujdes parësor shëndetësor, të gjithë studentët e komunës së deçanit e kanë të drejtë me mbajtur praktikën e qendra kryesore e mjekësisë familjare nëpër sektorët që i ka kjo qendër dhe nuk po besoj që dikujt i mohohet kjo e drejtë nëse ndodh diçka e tillë unë kisha pas qejf me qenë informueme sepse nuk e kam këtë informacion. Sa i përket listës esenciale të barnave këtë vit pa diskutim që kemi qenë shumë të mangët dhe arsyen po besoj edhe e dini po pas shumë takimeve që na i kemi mbajtur me ministren e shëndetësisë duke e falënderuar për mikpritjen që na ka bo e po besoj që prej vitit tjetër ka me qenë e zgjedhur kjo situatë dhe nuk ka me pas telashe të tilla faleminderit për pyetjen.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues, të nderuar koleg une kam pergatit 3 pyetje per kryetarin por meqenese kryetari nuk eshte prezent atehere po i shperndaj ne drejtor te caktuara se pari do ti drejtohem drejtorit te arsimit te premten kam hasur ne disa shqetesime qytetarëve se ka pasur mungesa te personelit te arsimit ne shkolla a mund te na njoftoni se per cfare numri behet fjale ne cilat shkolla ka pasur mungesa dhe cfare ka qene organizimi, njekohesisht ju pyes se cilat jane masat qe do te ndermerren ndaj tyre per humbjen e mesimit behet fjale per viziten ne shqipëri per ditën e flamurit. Per Drejtoreshën e shendetesisë më duket qe ne maj Qkmf eshte pa drejtor qe nga maji.. Qkmf eshte pa drejtorë, cilat jane arsyet e mos zgjedhjes deri tani e pozitës së drejtorit? Kur dihet qe aty ka mjek me përvojë e qe i plotësojn të gjitha kriteret qe i kërkon edhe ligji mos i jepni hapësirës qe të flet qarshia, e cila veç ka filluar të flet për këtë temë dhe e fundit ju lutem vetëm pak dhe tani këtë pyetjen tjetër po i drejtohem drejtorit të shërbimeve publike edhe drejtoreshës së buxhetit dhe financave ka të bëjë me 2 vendime të kuvendit, vitin e kaluar kuvendi ka miratuar 1 kërkesë të ndërmarrjes higjiena për ngritje të tarifave dhe pyetja është pse nuk po gjejnë zbatim 2 vendime të kuvendit, ai prej 0,85 cent qe ka marrë përsipër komuna dhe vendimi tjetër këtë vit qe obligon drejtorin e buxhetit të bëjë shlyerjen e borxhit në shumë prej 50.000 euro, mjete këto të ndara nga të hyrat e bartura të cilat ende janë të pa paguar siç e dim të gjithë komuna i ka 3 kontrata të nënshkruara me ndërmarrjen, por nuk e dimë se me cilin kod buxhetor i paguan ato, sepse në buxhet nuk i kemi të specifikuar në interes te tegjithve do të ishte të dimë se sa është edhe borxhi total i komunës qe ka ndaj kësaj kompanie mendoj se kjo çështje nuk mund të vazhdojë kështu deri në pakufi, sepse edhe ndërmarrja ka obligimet ndaj punëtorëve dhe operatorëve të tjerë mendoj se kjo praktikë duhet të ndërpritet dhe vendimi.. kam menduar qe ky vendim të cilin e kemi marrë duhet të kthehet kuvend për shfuqizim njekohesisht kuvendi me 1 vendim të ri të autorizojnë kompaninë higjiena qe nga janari të ngarkojë gjithë klientët e saj me plus 0.85cent ose me 6.85, kjo është forma më e mirë për të përmirësuar 1 gabim politik do ta kisha quajtur unë qe i keni ofruar kuvendit për miratim në atë kohë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Mon drejtori i arsimit, Besnik Hulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Përsëndetje kryesus, drejtor, asambleist unë munges të personelit nuk kam pasur asnjëher përpos për veq disa rasteve kur kan pasur lëvizje ndërsa për festimin e festës, të 28 nëntorit besoj se 28 nëntori është fest për te gjithë dhe na ka taku me festu të gjitha shkollat kanë qenë në detyrë

Hajdar Sutaj

Mundësisht ta vazhdon drejtori ta vazhdojë drejtori fjalën.

Faleminderit shumë a pa dikush.. jo më falë Faton se fillimisht janë të lajmëruar të tjerë po Dafina më falni vetëm priteni radhën se ndoshta te gjith e kan shkurtë është Albesa, Yllarta pastaj ti Sylja, Blinera Drejtoresha Dafina Cacaj e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Në lidhje me pagesën e subvencionimit qe keni marrë në fillim të vitit prej të hyrave të bartura, po është shumë e vërtetë qe kemi votu dhe e kemi dërgu në ministri për zbatim, mirëpo nuk na u ka leju na u ka kthy mbas për shkak të përqindjes së lejuar për me bo atë pagesë ka qenë më shumë se 1 për qind e hyrjes dhe bartjes së të hyrave në kategorinë e subvencioneve realisht nuk kam pasur shumë pak në subvencione kam kërkuar me u bë, mi marr mjetet nga një kategorie me futë subvencione për me mujt me kry atë pagesë edhe ne bazë të ligjit të financave publike ka kaluar përqindja e lejuar dhe nuk kam mundur me e zbatu me bo at pagesë edhe nuk është bo edhe unë jam shumë më e lumtur se ju nëse shfuqizohet ai vendim dhe kalon në kompetencë të qytetarëve se është barrë shumë e madhe për ne me pagu edhe atë se në kategorinë e subvencioneve kemi mjete shumë pak për me mujt mi pagu edhe ato faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtoreshë. për fjale është Albesa Cacaj po më falni shikoni drejtorja me mirëkuptim domethanë lajmrohuni për fjale se nuk pe dia po deshironi me u përgjigj apo jo? Agnesa Vokshi e ka fjalën kërkoj falje kolege.

Agnesa Vokshi

Faleminderit kryesues.

Koleg, faleminderit për pyetjen e ne për dallim prej personave që folin nëpër çarshia a qysh ke ajo na jemi të orientum për me punu edhe synimi i jonë është me punu dhe jo rastësisht si pasojë e punës së madhe që e bëjmë jemi dal si kujdes parësor shëndetësor në bazë të vlerësimit që na ka bo pushteti lokal 1 ndër ma të suksesshmet dhe po pres nga opozita dhe me na përgëzu për këtë temë sa i përket pjesës së përzgjedhjes së drejtorit të qkmf-së e këtë javë ju sugjerojme me i përcjellë rrjetet sociale, e shihni e kush është përzgjedhë si drejtor i qendrës kryesore të mjekësisë familjare faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Më falni se nuk po lëjm kështu debatin dikush tjetër nuk pat me u përgjigj te Moni apo jo, Atëherë Albesa Cacaj fillimisht, definitivisht.

Albesa Cacaj

Atëher edhe një herë përshëndetje për të gjithë kështu që e theksova në fillim të mbledhjes unë kamë bërë propozimin ne komision për ndarjen e bursave qe vendimi që u marrë në asamble në mbledhjen e kalume për formimin e komisionit të vijë prapë në asamble të shfuqizohet dhe të themelohet komisioni i ri ne bazë duke respektuar rregulloren për ndarjen e bursave këtë e them me argumentin sepse kur është ardh propozimi nga dka-ja, drejtoria e arsimit në komunën e deçanit për tu themeluar komisioni i bursave ne si asamble kemi marrë vendim, por duke ju shmangur ose duke mos e respektuar nenin 5 qe po e lexoj, i cili thotë kështu, komisioni për ndarjen e bursave për studentët e formon asambleja komunale 4 anëtarë nga asambleja komunale, 1 anëtar nga zyra e kryetarit, 1 anëtar nga dka-ja, i cili përkujdeset për dosjet dhe gjithë procedurën e konkursit dhe 1 anëtar nga shoqëria civile. Pra te neni 5 kemi shmangie kur thuhet 1 anëtar nga dka-ja i cili pastaj neni 6 i 7-të i bien detyrat dhe përgjegjësitë, detyrat punë teknike administrative që janë të nevojshme gjatë tërë këtij procesi pra këtu është mungesa ose shkelja e 1-rë, pastaj i nderuar kryesues kur ne na ka ardh në mbledhjen e 1-rë të komisionit vendimi për formimin e komisionit edhe këtu ka shkelje ose mos respektim të procedurave nuk duhet të flas me emra të përveçëm, por unë e kam hallin te fenomeni gjithmonë që 12 vite sa jam pjesë e asamblesë dhe e komisioneve të krijuara dhe themeluara në vazhdimësi ne kryesuesin ose kryesuesin ose kryesusen e kemi zgjedhur në bazë të 1 procedure, ku me anë të votimit, ndërsa këtë rast te ky komision kryesuesja ose kryesuesi, siç e thash edhe njëherë, nuk është që kam problem me emra të përveçëm është ardhur i zgjedhur dhe kjo është shkelje pastaj te pika 2 e këtij vendimi, thuhet komisioni sipas rregullores, për ndarjen e bursave për studentë, për studentët e komunës së Deçanit cakton kushtet dhe kriteret për të qenë përfitues i bursës përgatit aplikacionin dhe hap konkursin publik komisioni nuk rëndit ose nuk cakton kushtet, por jo te caktume ne rregullore, as nuk hap konkursin publik, sepse konkursin publike e hap drejtoria e arsimit, pastaj 1 shkelje që besoj ju ka rënë të gjithëve në sy është edhe

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë për fjalën kështu po hajt përfundo edhe gjymë minuti.

Albesa Cacaj

Ne publikimit të konkursit drejtoria, drejtoria e arsimit ka publiku kriteret me pikë gjë që në rregullore nuk janë kriteret me pikë do me thënë ku është bazuar kështu që kërkoi sot që ky kuvend të shfuqizojë këtë vendim dhe të merr vendim qe te themelohet komisioni në bazë të rregullores, duke mos bërë asnjë shkelje faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë e nderume, e para nuk është ndonjë situat a ndërrohet komisioni, a qëndron ky komision, nuk ka diqka, se prap se prap do të thotë me një fjal po du me thanë që nuk është kijamet edhe nese osht marr ndonje vendim, vetem dua të pys a je kanë në mledhje ktu kur ëdhtë votu a ke marr pjesë atë ditë në séance, a ke qenë? Jo jo, tash domethonë ti ke qenë këtu dhe të gjithë kanë qenë këtu dhe të gjith e kanë pa është dashtë me ditë rregulloren edhe është dashtë me ditë propozimin dhe duke e ditur rregulloren dhe duke e ditur propozimin e kem diskutuar, dhe unë nuk kam qenë penges për asnjë lloj propozimi, e kemi pyetur edhe drejtorin, a bën me rrit numrin, ka thënë ju jeni organi më i larti, është transkripta janë inçizimet, ktheni ato video do më thonë unë nuk kam asnjë interes as personal a si subject, prap se prap në shumicë kalojnë, dua të them që ju si komision jeni votuar me vendimin e kuvendit. Vendimin e kuvendit e kamë përcjellë në APL, APL-ja e ka kthy positive, sepse është në harmoni të plotë me ligjin, tash ju si komision mundeni me vazhdu punën sipas rregullores, po ju nuk munedu me u kthy ma se qka u dasht me bo kuvendi do me than ju si komision nuk e keni atë kompetenc për me u kthy mbrapa e me thanë jo kuvendi keshtu e ashtu, sepse ju jeni zgjedhur në bazë të një vendimi të kuvendit a po kupton, nëse ndonjëri nga ju është i paaft me perfundu punën e sjell dorëheqjen me shkrim dhe ne e plotsojmë në mbledhjen e parë përndryshe unë nuk sho asnjë arsye me kthy

vendimin e kuvendit sepse është miratuar dhe është kthyer nga minsitria që është në harmoni me ligjin e ligji është më i madh sesa rregullorja a po kupton edhe këto fjalë që i theksohet është dashur të thuash edhe atë ditë jo me pranë mu zgjedh pjesë e 1 komisioni që është në kundërshtim që është ka zgjedhjet kundërshtim me rregulloren, sepse unë nuk kam qenë pengesa atë ditë, për asnjë opsion të mundshëm përkundrazi ju kam pyetur qysh të doni po ja bëjmë edhe me kaq e përfundova këtë debat këtu kthehemi pastaj kur të i vie radha se janë kolegët tjerë është Yllarta Thaqi pastaj Vatoni Istrefaj nuk ta përmenda emrin më fal një minut se nuk është pikë e rendit të ditës kjo të të ndryshmet Yllarta Thaqi e ka fjalën pastaj prap kthehemi të të tjerët që kanë diskutuar.

Yllarta Thaqi

Ju faleminderit i kam 2 pyetje njëren për drejtoreshën buxhet dhe financa dhe një për drejtorin për bujqësi. Për kategoritë e lirisë, desha me pyet drejtoreshën për buxhet dhe financa në dhjetor të vitit 2023 bashkë me grupin e grave asambleiste ishim për vizitë të shoqatave të dala prej lufte dhe i përgëzojmë për punën e tyre e njëkohësisht i kemi nderuar me mirënjohje aty dhane ne zotim se do të mbështesim në kërkesat e tyre, poashtu edhe për çfarëdo që është e nevojshme. Sot e mora një shqetësim nga shoqatat e dala prej lufte ku më është kumtu se nuk është kryer pagesa si organizata jo qeveritare, të cilat kanë aplikime mënyrë të rregullt për subvencionim sikurse organizata e tjera të gjitha organizatave joqeveritare janë ndarë mjetet për të kryer veprimtarinë e tyre përpos shoqatave të dala nga lufta ju ka nda vetëm 1 pjesë e mjeteve dhe e cila ka mbetur ende e pashpërndarë për arsye se kanë qenë 4 shoqata dhe nuk ka pas mundësi sesi të shpërndajnë auto mjete ku qëndron arsyeja pse nuk janë subvencionu 1 kategori e cila kryen punë jashtëzakonisht të madhe brenda vitit njëkohësisht është kategoria më me vlerë në vendin tonë. Po ashtu kam 1 pyetje për drejtorin e bujqësisë lidhur me hapjen e konkursit për sera është hera e parë jemi gëzuar shumë, deri ku kemi mbërri me procedura dhe kur do të vazhdojnë që ndahen me apo të klasifikohen njerëzit të cilët do të jenë përfitues faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Yllarta, Dafina Cacaj e ka fjalën pastaj drejtori Rifati.

Dafina Cacaj

Po është e vërtetë që kemi mbetur borxh edhe 2.000 euro Ovi-ve me mirëkuptim unë kam biseduar me ta për shkak se nuk kanë dalë mjetet, edhe i kemi metë obligim, mirëpo kemi biseduar me ta dhe kemi diskutuar që në fillim të vitit e bartim obligime dhe ju dalim edhe ato për shkak të shumë arsyeve përmbaruesi na i ka marrë edhe 10.000 euro ne subvencione dhe ma ka qrrregullu pak shpenzimin të cilin e kam pas të planifikim për muajin tetor kur edhe ka pas me ju dal mjetet kjo është arsya

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtoreshë drejtori Rifat Stojka e ka fjalën.

Rifat Stojkaj

Faleminderit kryesueses për fjalën Yllarta faleminderit për pyetjen po thirrja për aplikime veq është mbyll sod jan bërë 3 javë që kur është mbyll thirrja janë gjithsej 68 aplikantë dhe do të shpërndahen, përfitues do të jenë 55 fermer në kuadër të aplikimit, komisioni për verifikim veq vshtë bërë e ditët në vazhdim do dalim terren edhe gjitha procedurat çfarë kërkohet do të del edhe lista e përfituesve, por kohë nuk kemi kohë të caktume, por që besoj për një muaj, sepse gjithë fermerët do të vizitohen do të shihen a i plotësojnë kriteret për 1 muaj besoj që del lista me fituesit faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor Vatoni Istrefaj e ka fjalën.

Vatoni Istrefaj

Faleminderit kryesues Së 1-ri do të ishte mirë që të na tregoni arsyen pse kryetari i komunës nuk është sod këtu bashkarisht me ne seancën komunale

Hajdar Sutaj

Kryetari e ka Institutit për krime domethan që ka ndodh gjatë luftës në Kosovë dhe janë bashkë me një takim domethonë sot që prezantohen edhe materialet e krimeve që ka ndodh gjatë lufte në komunën e deçanit kërkoj falje se ndoshta vshtë dasht unë me tregu por faleminderit për pyetjen

Vatan Istrefaj

